



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR  
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 1141/2 Prot

Tiranë, më 09/10/2023

**NJOFTIM**

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor, në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi Punës i RSH", i ndryshuar; Ligjit Nr.10 352, datë 18.11.2010 "Për Artin dhe Kulturën" i ndryshuar; VKM-së Nr. 176, datë 29.03.2006, "Për botimin e buletinit të njoftimeve publike"; Urdhër të Kryeministrit nr 140, datë 28.03.2014 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së TKOBAP-së"; Statutit të Institucionit të TKOBAP miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr 166 datë 27.04.2015 neni 15 gërma c; Rregullores së Brendshme "Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucionit të TKOBAP-së me nr.1850 prot datë 25.07.2014; të shpallë 1 vend vakant për pozicionin e punës:

❖ **Koriste e Kategorisë së Dytë në timbrikën" Mezzosoprano" në sektorin e Korit pranë Drejtorisë së Operas dhe Filarmonisë:**

Për t'i dhënë më shumë kohë shpërndarjes së informacionit për vende të lira pune në sektorët artistikë e për rrjedhojë për t'i krijuar mundësi pjesëmarrjes më të madhe në numër të konkurrentëve, TKOBAP nxjerr njoftimin e saj ditën e sotme, për vendin vakant Koriste e Kategorisë së Dytë në timbrikën" Mezzosoprano" në sektorin e Korit pranë Drejtorisë së Operas dhe Filarmonisë:

**-Kandidati/ja duhet të plotësojë kushtet për konkurim si vijon:**

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën e provuar me dokumentacionin përkatës;
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje e çertifikuar nga shteti i tij;

6. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

**Të gjithë artistët që janë të interesuar për t'iu nënshtruar audicionimit, duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokollit të Institucionit të TKOBAP-së deri në datën 01.11.2023, ora 16:30 dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:**

**Dokumentacioni:**

1. Të ketë kryer studimet e larta mastër diploma (kanto) brenda ose jashtë vendit;
2. Fotokopje të diplomës dhe listë notash të noterizuar;
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) ose një dokument ekuivalent me të;
4. Fotokopje e dokumentit të identitetit të vlefshëm;
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore, ose një dokument ekuivalent me të;
6. Vërtetim të gjendjes gjyqësore, ose një dokument ekuivalent me të;
7. Një kopje të Curriculum Vitae bashkëngjitur me Foto, (veprimtaria në vite e çertifikuar, mastër class, Work shop, programe koncertesh, recitalesh, shfaqje të ndryshme, si dhe të dhëna të tjera që plotësojnë figurën artistike, experience pune për vendin që aplikon, tituj artistik etj). Dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar këtë kriter;
8. Të ketë njohuri minimalisht të 2 gjuhëve të huaja, italisht dhe anglisht.

**Programi i detyrueshëm për këtë audicion:**

1. Tre arie të ndryshme nga operat sipas dëshirës së kandidatit, por nga repertori i W.A.Mozart, G.Verdi ose G.Puccini dhe J.Massenet ose Ch. Gounod etj.
2. Shtrirja vokale (Vokalizë).
3. Lexim me shikim të parë.

**Pjesë korale të detyrueshme.**

- J. Brahms – “Ein Deutsches Requiem”- op. 45 nr. 4 “Wie lieblich sind deine Wohnungen”;
- G. Rossini - “Stabat Mater”- Nr.10 “Amen”;
- G. Verdi – “Messa da Requiem” - “Libera me”;
- G. Puccini - Opera “Tosca”- “Sale, a scende l’umancantico”;
- G. Verdi - “Aida”- “Gloria all’ Egitto” (Ed. Ricordi fq. 109 – 144).

**Shënim:**

**- Komisioni ruan të drejtën që të dëgjojë të gjithë ose një pjesë të programit të konkursit.**

**-Nëse kandidatët nuk kanë shoqërues në piano me vete, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor do vendosë një shoqërues në piano në ditën e audicionit pasi të jetë lajmëruar minimalisht 3 javë përpara.**

Për sqarime të mëtejshme, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni në adresën:  
[sekretaria@tkob.gov.al](mailto:sekretaria@tkob.gov.al)

**MIRATOI**

**DREJTORE E PËRGJITHSHME**

**Abigeila VOSHTINA**

